

8JH-1

M 98

**SHEVQET
MUSARAJ**



B JH-1
MI 98



SHEVQET
MUSARAI

1562



SHEVQET MUSARAJ

PERËNDIM

Si disk metali në kaminë
i skuqur flakë nxehtësie,
i dritës mbreti udhëtimnë
po merr teposhtë honit-hije.

Nga udha lodhur, dalngadalë,
si me përtesë rrokulliset, —
mbi faqe deti e lart në male
kurorë zjarri zë qendiset.

Më poshtë fusha nën ullinjte
nga zëra mbrëmjeje ushton:
e drojtur dita qan të ritë
e saj, që nata po ia zbon.

Limani i purpurt, gur kufiri
me trollin tonë¹⁾ shekullor,
dridhet si fletë trëndafili
nga fllad i lehtë pranveror.

Pastaj në heshtje bie dremitur,
teksa një valë ledhatare,
rërës së bregut duke zbritur,
ia thotë këngës lozonjare.

1929 (*Ujë i Ftohtë — Vlorë*)

(*Botohet për herë të parë*)

1) trolli ynë — Sazani, kundruall Ujit të Ftohtë që kish mbetur nën pushtimin italian gjer në fitoren e 29 Nëntorit, 1944.

M E N G J E Z I

Mal' i luftës së njëzetës, si kështjellë e kreshpëruar
gjeth' e lule rreth stolisur, në agim të vagëlluar, —
gjer te retë e verdha sipër ngjitet, ngjitet e
humbet, —
krenarinë e luftës së shkuar mban në zemër e nuk
flet.

Nga Azia perandori¹⁾ vargonjartë, perdegrisur,
nëpër pluhur të agimit, duke rendur si i krisur,
kundalit²⁾ të rimtin qiell, det të tyhtë, që po fsheh
yjt' e natës brënda gjirit ngjyrëkaltër kadife.

Rreth agimi veshur rroba gjak e purpur fund e
krye,

1) dielli

2) Kundallt — përkund, trazon

hedh gostekun majë malesh. Maj' e Çikës ja u
ngjye.

Nat' e zezë përtej detit u luhat dy a tri herë
pastaj frymë dha e humbi avuj-avuj në eterë.

Tej e tej Shashica e lartë ngjallet, çelet pak
nga pak.

Ja, tej detit, robëruar, ndrit me zor Sazani plak.

Faqja e detit, vaj e shtruar, qesh e lot me fillad'n
e erës.

Varkëtari nis lundrimin e mëngjezit të pranverës.

1929 (Ujë i Ftohtë — Vlorë)

(Botohet për herë të parë)

N Ë F S H A T¹⁾

Kush s'ndjen mall për në shtëpi,
kur bën dimër si nashtinë,
kur derdhet breshër e shi
me tufan e suferinë?

Vatra me kopeç ngarkuar,
shkoqet prushi si ngaherë;
të gjithë prakut rrethuar,
fryn jasht' e bie paprerë.

Mbi male qielli nxirë
nga re, që shkrepin rrufeñë,
tejpërtej mjegulla shtrirë
ka zënë e s'e lëshon dhenë.

1) Kjo është poezia e parë e botuar e autorit

Kodra, brigje, maja, fusha
të zhveshura, gjoksin thatë, —
mbi 'to sokëllin arusha,
er' e rreptë dit' e natë.

Malet pleq e fiokëthinjur,
të vrenjtur, nga lart vështrojnë;
si luanë të panginjur
thellë nën gjoks rënkojnë.

Buçasin lum' e përrenj,
kërcet lisi i madh, vigan
kur e shkul ujët me rrënjë,
e rrëmben buzave bran.¹⁾

Një zë, si nga tjetër botë,
i mekur, gjithë trishtim
dëgjohet portë më portë;
kush të dalë s'ka guxim...

9 shkurt — 1929

(Botuar në «Gazeta shqiptare» të Barit)

1) bran — zvarë

BUJKU I HANKO HALLËS

(Poemë)

Zotit A. A.

Çeli buzë malit diell' i pranverës,
shkon këng' e xhurasë mbi tallaze t'erës,
erës së mëngjezit, dallgës ledhatare,
që shkon mbi kodrinat nuse legjendare...
Lulet e pranverës çelën ndër lëndina,
lodr' e valle hedhin vajzat gjeraqina;
këng' e valle vajzat, vall' e lodra gratë,
lum' kush qe m'e zonja, mëngoi që me natë.
Këng' e lodra gazi, shesheve t'tërfilta,
ndjek me zë të dredhur faqetrëndafilta, —
gushëpullumbesha vajz' e fshatit tënë,
nuk e shquan dot: diell apo hënë!
Le pa le të tjerat, fill'e në mbarim,
mu si yjt' e bukur përmbi përëndim...
Sa lezet u paska kënga dhe gëzimi, —
kënga shumë e bukur, nisja nga fillimi!

Ç'paska lindur vendi, ç'paska rritur fshati,
mbushur kodr' e sheshe, na u shporr netëgjati,
netëgjati dimër, dimër korkosuri¹⁾, —
gjeth' i gjelbëruar drit' e gaz na pruri.
Dit' e pranverës, oh ç'dit' e shënuar,
dëftoi shpresa plot porsa pat' aguar, —
gjithë fshatrat këngë, gjithë fshatrat gaz,
këng' e gaz ngahera paçim dhe më pas...

*

* * *

Vetëm buzë gardhit, gjeth' e bar ngarkuar,
rri me ballë vrenjtur një bujk i mejtuar:
zemra s'i bën fare, s'i qesh ajo buzë,
ngjeshur ka për mesi kacav²⁾ 'e tërkuzë;
tund kokën hutuar, vuan e rënkon
e ka humbur fare, s'di sepse mejton.
Dhe duke mejtuar flet me zë të prerë:
«Mbeti puna shkretë! Luaj mor' i mjerë!»
Krahët nuk i bëjnë, s'është më i ri,
mejton hallemadhi, — ka një tok fëmi.
Dhe duke mejtuar rri si pul' e truar...
Flet me të ngadaltë gruas së harruar,
që po shkon pas shoqesh udhës për lëndinë

1) dorështrënguar.

2) Kacave — sopatë e vogël

me mendjen mbi kokë, tam ku ka shaminë:
 «Eja, moj e shkretë, bjer' shat' e kazmare!
 Ç'i duam na vallet? Mbeti puna fare!
 Iku koh' e punës! Nuk e sheh që mbemë?
 Kam tri dit' që nisa, s'kam mbjell' as një stremë!»
 — Dale mor' i bardhë, mos e nxito punën,
 le më nj' an' çëpërkat²⁾, lësho pakë gunën, —
 duhet të urojmë me përunj' e ndere
 Hanko Hallën tonë për ditë pranvere.
 Pa pastaj t'i bie kazmar' e lopatë, —
 nuk na shkoi koha, dita është e gjatë.
 — Mortja që s'të hëngri, plaç si gjinkalla,
 për urimet tona u dogj Hanko Halla!
 S'ia kam ngen' asaja, kam punët e mia,
 Hanko Hallën tënde, nuk ma nxë shtëpia.
 Mos më pleks me Hankon, se s'ia kam dot ngenë, —
 shiko pakë diellin, hipi tre hostenë.
 Berrat duhen parë, djemtë duan bukë,
 njëmij' e një halle, s'kam mëndje në kukë.
 Hanko Halla jote rri në fron me fletë,
 hallet e kusuret i ka bujku i shkretë.
 — Mba gojën e hidhur, s'është' si thua tinë,
 Hanko Hallës sonë do ia bëjm' timinë³⁾;
 jemi bujq të saj, s'kemi ku të vemi, —
 nderjet e timitë për detyr' i kemi.

1) stremë — masë toke afro një dynym.

2) çëpërkë — rraqe.

3) timi — nder

Duhet ta urojmë jet' për shumë vjet,
 për djalin e vogël që ka në kurbet.
 Në rri kryelartë, nuk ke se ç'i thua;
 që mba lartësinë diç e ka për sua.
 — Rri, paç Zotin ndihmë, mos na mundo kotë
 dhe sikur të vemi kushedi ç'na thotë, —
 sikur s'e njeh Hankon gjithë salltanet.
 Kur të flet një herë mu sikur të vret,
 mu sikur të bie syve me pëllëmbë, —
 për një gjysmë fjale të merr nëpër këmbë.
 Për një thes të grisur, tërvit, Hanko Halla
 më përzu' nga dera, më hodhi nga shkalla;
 më bë copë-copë, mezi më la tragë,
 mu në sy të gjurit dhe sot e kam plagë.
 Ik' a lumëmadhe, le Hankon më nj'anë,
 Zoti të na ruaj, do gjejmë belanë.
 Hankua s'do nga neve nderim' e timira, —
 ia kam gjetur zemrën, — për atë m'e mira
 qënka të punojmë me nat' e me ditë,
 të thurim gjerdhet, të prapsim llomitë¹⁾,
 të çajm' e të mbjellim me koh'e pa kohë,
 në shi e në breshër, në bor'e në llohë.
 Hanko Halla jonë s'do nder as lezet, —
 në pun' e në lumë do që të na tret'.
 Është zonj' e pasur, jemi varfanjakë,
 ne kemi kasolle, ajo ka oxhakë.

1) llomi — llucë, baltë.

Ik të zëmë punën, të vështrojmë hallë,
 kazmën e lopatën sa të jemi gjallë...
 — Ç'bën kështu, mor burrë, pse helm'e zhiva
 hedh në shpirtrat tanë kusuremëdha?
 Kështu kemi bërë, kështu jemi rritur,
 nëpër ferr' e driza, këmb' e duar çitur.
 Kështu ndahet jeta: një na paska shumë,
 tjetri s'paska fare, — rron lum' e për lumë;
 njëri sofrën plot, tjetri bukën thatë, —
 më e shumë' e botës rron me kazm' e shatë.
 Mjaft dhe buk' e gojës, mjaft dhe drut' e zjarrit,
 dimrin në kasolle, verën hijes së qarrit.
 Takëm' e stolira, pallat' e shtëpira
 qofshin për kë janë; ne gunat e dhira
 kemi për takëme, tjetër gjë s'na lipset, —
 me flori s'na kihet, me mëndafsh s'na kripsset.
 Hanko Halla jonë është pasanike,
 der' e par' e vendit, me miq' e me mike.
 — Kam të drejt' i ziu, kam të drejt' i vrari,
 Hankos pasurinë ia ka lën' i pari;
 vet' s'ka derdhur djersë, vet' s'është lodhur fare,
 pasuri të krahut s'ka asnjë pesare¹⁾.
 Neve djersa çurqe na shkon dit' e natë,
 më në fund, të zestë, dalim duar thatë...
 Hanko Hall' e Madhe, gjithë salltanete
 s'ia ka kuj' për pesë, qeveri më vete;
 rron me ç'i do zemra, rron Sulltan Hamiçe,

1) pesare — monedhë e vogël e kohës turke.

alla turqërishte, Ali Pashalliçe.
 Rahmet past' i jati, rahmet past' i shoqi,
 koh' e Babaqemos në mall i përpoqi;
 me djers' e pa djersë, me nëpunësira,
 vunë miq' e shokë, qemere¹⁾ plot lira.
 Me gjak fukarai u fryn' e u rritën,
 mbi kasolle kashte kështjella goditën...
 Hanko Halla jonë mbahet shum' e madhe, —
 katërmij' dynymë ara dhe livadhe;
 fusha sa të duash, pyje dhe nomé,
 gjë të gjallë malit tri katër kopé;
 ullinj' e dyqane, para me uzur²⁾ —
 në flori të dojë, gjithë botën thur.
 Mbahet më të lartë, lart e shumë lart,
 njëqind napolona një stoli e artë.
 «Pasurinë — thotë — Zoti m'a ka falë».
 Dy çapa larg derës shkon në kal' me shalë,
 qehaja përpara, qehaja dhe prapa, —
 s'ka par' e provuar ç'është ftohma e vapa.
 Gjithë ditn' e zotit në pallate rri,
 të rinjt e të rejat merr në lemeri.
 Shan e qesh të tjerët, tallet me të rrinjtë,
 hap e mbyll sepetet, numëron florinjtë...
 Krushq' e fis e soj, nipër, miq' e bija, —

1) qemer — brez që ngjishej në brez e që shërbente për të mbajtur pare ari.

2) uzurë — kamatë, faiz

një karvan më ditë pret e nxjerr shtëpia.
Der' e Hanko Hallës është' der' e vjetër, —
atë që bën Hankua s'e bën derë tjetër.
Shtruar dit' e natë doli e sinira,
për të radhës saja respekton zakonë...
Bujqit, hyzmeqarët — vetëm krodhën thatë,
pyjet e zallijtë, punën që me natë.
Hanko Halla shlodhur rrotull penxheresë,
bujqit e barinjët nuk i ka për pesë,
sikur ne nuk ishim, sikur ne nuk jemi
njerëz si Hanko Halla që denbabadeni.
Hanko Hall' e Madhe, s'ka turp zemërzeza,
«Jam — thot' — der' e parë, derë dyqind breza».
Jemi ne të shkretët dyqind e përmbi,
po nga skamj' e shkretë s'na përfill njeri...
Vajzat po ia thonë...
në këng' e në valle mbytnë vendin tonë!
Lumi duke bredhur fushës oshëtin,
diell' i pranverës ndrit e vetëtin...

1934

(Botuar në revistën «Minerva» shkurt — 1935)

VËSHTRIMIT TËND

Vështrimi zjarr i syrit tënd
seç m'i rrëmbeu zemër e mend,
më la në rim¹⁾, më la fatzi,
më la pa strehë dhe pa vend.

Të ndahem, them, nga njerëzit e mi
e larg të shkoj (se ku, nuk di);
vështrimi yt po më shpërndan
si renë era në stuhi.


Ç'vështrim qiellor, moj, që më ke,
ballsam për zemrën kallogré;
një rreze dielli n'errësirë,
shkëlqim rrufeje nëpër re.

1) në rim — në katër rrugët, në shkretëtirë.

Ndër mend më rend kryq e tërthor
i hijshmi yt vështrim qiellor
e këmbët nuk më zënë dhe,
kërkoj e s'gjej një gisht fole.

1935

(Botohet për herë të parë)



~~1562~~

MENDIME DHE LOTË

Për bukë goje rrah edhe mendoj, —
si skllavër e nxjerrim, s'dilet tjetërsoj;
në skllavëri edhe mezi e gjejmë
dhe atë që s'bëhet, nga e keqja, e bëjmë...
Pa rrim' të truar¹⁾, të mërzhitur,
ngaherë të uritur,
sado që djers' e gjak për botë i ndejmë.

E skllav pra, skllav po rroj në jetë, —
s'më bëhet, se m'i dha natyra vetë
mjerimet, skllavërimin...

Kam koh' e kohë që lodh mendimin:
Natyra? Qysh!? Natyra? Jo, mor' zot.
Ahere pse më lindi? Mos më kot?
1936

(Bo'ohet për herë të parë)

1) të truar — të ndrojtur

KATUNDARËVE

Katonjt, konakëritë,
në t'errët ku u shkritë,
ku dita duket muaj,
nga lott' u bëtë ngjill.¹⁾

U vratë, u copëtuat,
u shëmbt', u shkretëtuat
e sot në vëndin tuaj
s'ju ka njeri për fill.

O burra djem të gurit,
të shatit, të sopatës,
të kazmës, të lopatës,
të shpellës, të haurit

1) ngjill — pellg

nga vend' i më fundosur
në vojte e në rrëmuje,
për faj të tjetërkuj,
katilash shpirtlyrosur,

radhosi¹⁾ të gatitur
se mjaft në tokën tuaj
jetuat si të huaj.

Radhosi, përgjërohi
nga kurr' më mirë vonë,
barutin mbi padronë
rrufe mbi ta lëshoni.

E këmbë të mos lini
në ta që të shpëtojë,
se s'bëhet tjetërsoj:
është' dita sot, u bini!

Fuqinë dhe paratë,
sundimin e lirinë,

1) radhosi — radhituni.

kolltukun e florinë
me djers e gjak q'ua dhatë

nga kthetrat ua rrëmbeni.
Si difa, si dragoj
të gurit q'u krijoi,
barutin mos kurseni!

Flamurin e çlirimit
të ngrini sot në botë
e këngës liriplotë
ia thoni rruzullimit.

1936

(Botohet për herë të parë)

VITIN E GJASHTË...

I

Që kur të pashë vit'n e parë
m'u ndez në zemër adhurimi
e të të njoh mundova veten,
po më mungoi sa çmos guximi.
Pa ndenja larg, s'tu afrova
si korb në shkretëtirë vova.

II

Mu duk një shekull se pat shkuar,
kur të ripashë vit'n e dytë;
një pluhur malli, dhëmshurie,
një lot i vakët më zu' sytë.
Në gjumë t'ëmbël u rrëzova, —
shkoi shumë koh' e dot s'u zgjova.

III

Perëndoi prap' një koh' e gjatë
që kur të pash' të tretin vit;
ngarenda pas, por u pendova
nga drojtja se mos të mërzit.
Dhe s'të mërzita, ndenja larg:
bregat në zemër binin varg.

IV

Sërish u pamë vit'n e katërt,
dhe malli prap ma zgjoi poterën
sikur sodita diellin vetë,
sikur rizura pranverën.
E shpirti zjarr, e zemra mpirë
ma pritën aq me gaz zefirë.

V

Por vit' i pestë prur' më dritë
që kur u shporr nga ne mërgimi;
ti ishe larg, u afërove
si lule e rritur gji burimi
me shumë ngjyra dhe aromë, —
më e hijshmja lule e vëndit tonë.

VI

Të pashë prap' e sytë s'ti hoqa
të gjashtin vit më shpresë plot,
të mora pas e më s'po kthehem
se dhe të dua s'kthehem dot...

1936.

(Botohet për herë të parë)

V E T Ë M T Y...

Lulet vesën, unë lotët, —
veç këta më ndjellin jetë;
lulet diellin, unë tyja
kam për dritë të vërtetë.

.....

S'zotëroj në veten time
veçse ëndërra një mal,
pa dhe lumturinë n'e gjetsha
do ta korr e të ta fal.

Frill — 1956

(Botohet për herë të parë)

FOL', POET!¹⁾

Në rrëzë kodrash, gji zallijesh
një det nga valët nanuris;
andej më lart, atyre hijesh,
Poeti vjershën zë qindis.

Rreth tij ullinj të puzhulitur
e gropa dherash fundëruar
e vende e brigje të roitur:
pasqyr' e kohës së kaluar.

Më tutje varre dhe hendeqe
me eshtra e kafka njerëzore,
më t'hu opinga, breze, leqe,
mbi bezga kalbet një mëngore...

1) Poezitë e këtij cikli janë botuar për herë të parë në revistën «Nëntori» (1964).

Kush qen' këta të bërë copa,
këta që sot s'u gjendet tragë?
E ç'eshtre tretin këto gropa
mbuluar hithës e mëllagë?

Oh, fol, poet, e mos u druaj,
si pyet jep edhe përgjigjen
e botës tërë ngreu e thua,
mos mbyl, mos mbyl ashtu ndërgjegjen!

Heronjt' e trollit të thërresën,
Poet, me shpirt t'i ligjërosh
spartanet gjokse-arbresh' e besën,
q'u hodh' pa turp e cip' në llosh¹⁾.

Se aty çdo lladë²⁾ dhé, ku shtruar
në gaz ia kanë pasanikët,
bastun ergjëndësh nëpër duar
e ver' e fruta nga çiflikët, —

aty çdo copë vend e lerë
me gjak t'arbreshit është ngjyer, —

1) llosh — mbeturina, plehra

2) lladë — pëllëmbë

u ble më shtrenjt nga ç'e kan' blerë
arhondët tanë gjuh' rrëmbyer.

Ata që flasin e s'peshojnë
se brumë kanë dhe flori,
që s'ndjejnë, s'din' e s'kuptojnë
se kujt i thonë Shqipëri,

nga vënd i mbrujtur gjak titanësh
pallate e prehje kan' thëthitur,
çifliqe e robër gjith' anësh,
për bark e qejfe të stërvitur.

Ndërsa në luftë kush vrapoi
me zjarr në zemër jetën dha
e kush për fat të zi shpëtoi
pulqer¹⁾ në magjë nuk ka.

Rrëmbeje penën edhe shkruaj,
Poet, për hir të së vërtetës, —
sulmo, godit, në kokë gjuaj
me zjarr në majë të shigjetës.

1) pulqer — grimë, thërrime

Ç'THOTË VALA?

Det' i rrymtë që po zien
n'ato anë rrëzë malesh,
n'ata brigje, ku, me hijen,
burri trim të bën t'i falesh, —

ç'thotë, ç'thotë duke zier
n'atë rëngë¹⁾ monotone,
n'atë ngjyrë të përzier,
n'ato valë, n'ato jone?

Ç'thotë vala shkëmb më shkëmb?
Fol, Poet, e mos u tremb!

1) rëngë — rënkim

Vaj' i valës duke zbritur
buzë bregut shqipëtar
a mos është' fjal' e zhuritur
e atij brezi sedërtar?

E atij brezi që u shua,
q'u dogj flak' e u bë hi,
q'u hodh posht' e u harrua
tek i thanë Shqipëri?

Apo është rapsod i hedhur
që s'ka frik' nga ç'vjen më tej,
që ia thot' me zë të dredhur
siç ia tha në çdo betejë,

q'e rrëfen si ia ndjen shpirti
veprën shtrigë të mavijes, —
jo me kast¹⁾ a së pa hirti,
po me fund të vetëdijes?

Folë, poet, të lumtë goja!
Folë, mos droj, — për ty s'ë' droja!

1) kast — qëllim i keq

PATRIOTIT TË PËRBUZUR

Ti, me një gunë që s'mba andër,
në mes të udhës më je shtrirë,
si mos më keq me sytë e errur,
fytyra dyll' e duart nxirë.

Kushdi nga vjen, kushdi sa vojtje
këtij tufani ke pësuar;
me thes në krah' nga udhë e largët,
zallijesh grirë e copëtuar.

Pa buk' në trastë e shollë në këmbë
e këmbët tharë e ngrirë hekur,
si deg' e gjeshtës¹⁾ majë bregut
duke u dredhur e përpjekur, —

1) gjeshtër — gjineshtër

në mes t'udhës po lëngon!
Njeri s'të flet e s'të afron,
nga thik' e mprehtë e dëshpërimit
dhe zot e qiell po mohon.

Të pata njohur vjet' përpara:
ti ishe trim që s'pate shoq
e, as grykë për grykë kur re me vdekjen,
ty trimëria nuk t'u hoq.

Në njërin sup mëngoren mbaje
në tjetrin armë dhe gjerdanë.
e përmbi sy qylah'n e bardhë
siç ish zakoni n'ato anë.

E nise punën me të shtruar,
pastaj me forë¹⁾ e me furi
se të kish plasur zemrën koha:
nuk deshe jetën pa liri!

E si për dasmë, ti me shokë,
në luftë u nise guximtar;
asgjë s'ta ndali hovn' e shpirtit
që t'u pat ndezur flak' e zjarr.

1) forë — vrull, forcë

Po sot, ah sot! Furtunë e kohës,
më pa logjik' e pa mëshirë,
në varfëri, në mospërfillje,
në mes t'udhës të ka shtrirë.

Në mes t'udhës, si i mjerë,
nga lotët sytë buhavitur
e lotët derdhen duke shkruar
mbi faqe fjalën «i uritur».

Për ty, pjellë e kësaj balte,
që s'le kusur për këtë vend,
po tingëllon në krah' të kohës
ora fatale e fundit tënd.

Po tingëllon e kush nga prehja
s'u ngrit e s'erdhi të të qan
e hidhërimn e zemrës sate
më dysh me vete të ta ndan.

Ti vdes me helm e vrer në zemër,
ti vdes me brengë e daramet¹⁾
se, jo kurorë dhe flamurë,
po asnjëri pranë nuk t'u gjet.

1) daramet — brengë

N J Ë S H O K U *)

Kur shuhen yjet e pas agimi
zë dielli lind praruar,
të shoh në napëzë kujtimi
në breng' e të munduar...

Pa nis në zemërën e etur
një tjetër «ah!» të ndryj,
atë të shtegëtarit mbetur
në net' pa hën' e yj'.

Sa kohë shkoi e s'të kam parë,
ja malli prap' më merr;
të flas me zën' e shpirtit vrarë
si nga më i fundit ferr.

*) Vullnetar në Spanjë.

Po ç'them? Ky zë prej thellësie
tej vendesh s'mbaret dot!..
Jetoj në rërë shkretëtie,
ku etjen shoj me lot.

(Botuar në «Përpyekja shqiptare», Maj — 1938)

E J A

Eja! Një lundër tej na pret.
Po ikën! Eja, mos u sill!
Mbi val' ergjënde zë po shket,
mbi uj', e leht' e vetëm fill...

Eja! se lundra velat shkrehur
për udhë larg ka zën' i ngrë:
nga puthje valësh, gjith' e dehur,
mes ngjyrash duket se po flë.

Eja! Po ikën! Mos mënó!
Aha! Ja, prapë po ma flet!
Si bota nis m'u trimëro:
është' lundr' e kohës që po pret...

Eja që sot e mos u sjell
në jetën tënde vetëmie,

lundra që pret, ja! po na ndjell
për rrymë tjera lumturie.

Eja me gaz e më mos rri
në burg të jetës, mos u mbyll!
I duhet lundrës një flori,
për netët terr një yll si ti,
si ti për jet' e vjet një yll.

(Botuar në «Përpjekja Shqiptare», Janar — 1938)

KASOLLES... *)

Ia thoj, vëlla, me ligje si di vetë,
ashtu si shpesh ja thua me trishtim
kur dhënt' e shqerrat mbeten në të shkretë
e nata e dimrit s'ka për ty mbarim.

Ligj' roja gjëmën sot kasolles sate,
q'e keshe streh' e vatër për fëmijë:
ia fryjti kashtrat er' e kësaj nate
e lumi, enjtur, rreh që ta përpijë.

E sheh ti valën egër si vërtitet,
i sheh themelet nga po shkulen radhë? —
Kasollja jonë, vëlla, po na roitet, —
klithm' e kushtrim ligj'ro, ti, mbi gërmadhë...

*) Variant i botimit në «Përpyekja shqiptare», Nr. 25
(Prill, 1939) që u ndalua të qarkullojë nga pushtuesit fashistë.

MËNGJEZ E MBRËMJE PAS DRITARES

Mëngjez e mbrëmje pas dritares
me penjë rri në duar:
qendi, andron, —
sa vashëz e duruar,
ti s'di pse lodhe aq e pse punon...

Sa herë fjalën njerë grindanjares
përunjshëm ia ke pritur.
Si e keqja që të zu.
(O vashë, vash' e mitur)
Se ashtu të dashkan gjithë njerëz't e tu.

Duron e fjalën dy asnjëj s'ia prrënd¹⁾
e shpres' edhe dëshira

1) prrënd — kthej, prish.

në zemër ndryn
siç e kërkon mynxyra
skllavëri, zakon i rënd'i vendit tënd...

Po zbrazet qielli krejt, se era ret' i shtyn
e drita zu po çel
në majë malesh,
si gjetkë dielli del, —
në shpirtin tënd, veç, drit' as diell s'po
mb'rrin.

(Botuar në «Antologjia» Nr. 1, Tetor — 1939)

KUR THYHET LUNDRA...

Kur thyhet lundra, lundërtar,
e ti mes valësh pa fanar,
kur deti s'pyet më kufi,
ç'bën ti mes valësh lundërtar?

Kur deti hapet edhe ti
mend po i futesh mu në gji,
kur vala zbret e mend të mbar,
o lundërtar, si ndihesh ti?

Si ndihesh ti kur vala zbret
më me tërbim, më me nefret,¹⁾
nëp'r atë det të egërsuar
si ndihesh ti lundrar i shkretë?

1) nefret = nervozizëm

Jam shok me ty u'¹⁾ dritëshuar
me lundrën copëra thërmuar:
u' jam mbi jetë, ti mbi det, —
jam shok me ty, lundrar i shuar.

(Botuar në «Antologjia», mars 1940)

2) u' = shkurtrim i fjalës unë.

Ë N D Ë R R

Pashë një ëndërr, ç'ënd'rr e zezë!
Sikur mbi male yjet ranë
dhe malet tejpertej u ndezë
dhe flakët plasën më çdo anë.

Pashë një ëndërr, ëndërr tmerri,
sikur e tërë bota u shkri;
pa ç'qe mbi tokë gjithë shteri,
bobo, e mjera njerëzi!..

Pashë një ëndërr... Po agimi
më zgjoi nga ëndërr-mavria,¹⁾
sikur ahëre njerëzimi
shpëtoi m'u duk nga skllavëria.

Tetor — 1941

(Botohet për herë të parë)

1) mavria — e zeza.

KËRKOVA JETË...

Kërkova jetë, jetë s'gjeta
tek zemrat rrahinë për ar;
kërkova prap' e jetë s'gjeta
në gjijt' e botës plot nakar.

E gjeta jetën tek s'e presë:
tek miz' e dheut që s'bën zë,
tek dheu i bashkët: buk' e djersë,
një për të gjith' e gjith' për një.

Tetor 1941

(Botohet për herë të parë)

LIRI POPULLIT PËR JETË

Duall' djemtë me bajrak,
zjen kushtrimi prak më prak:
shqipëtari kërkon hak
s'duron dot për gryke lak;

kërkon hakë e kërkon shpagë,
shpirti zjen e ndizet flakë;
zemra do melhem për plagë,
siç do tok' e djegur vlagë.

.....

— Ç'ka, nëno, që s'çel më bari,
ç'ka që djeg kështu behari?
— S'djeg behari — thotë nëna —
po djeg zemëra përbrenda, —
digjet popull hallemadhi,
digjet zjarr, më zjarr se zjarri.

Se në gafë i ra barbari,
Digjet zjarr e vjell' vrer',
edhe zemra thikë i ther,
se pa djemtë në neshter¹⁾,
se pa truallin në tmerr.

Pa Atdheun shkrumb e zjarr:
një këmishëzi barbar
djeg, burgos e vret e var
ku me plumb, ku me litar.

Korr' e ngrin e bën si do
me Pilatin për hero,
mbi gënjeshtër shkel e shko:
«Përça shqipot e sundo».

..... ::

Po ja, dita më s'mënon,
zë' i lutfës po gjëmon, —
armik qeni, kudo shkon,
këmba zjarr' i përvëlon.

1) neshter — brisk, thikë e vogël e mprehtë.

Pa hap sytë armik barbari
dridhet, prapa tij, tradhëtari,
klith e ulurin zagari, —
po ngre krye shqipëtari,
s'e përkuli plumbi e zjarri.

Ushton mali, zjen qyteti,
tundet vendi prej rrëmeti;
tepërtej gjëmon dhe deti.
Thonë bëhet kiameti;

thonë vjen një lum' me valë,
që s'njeh falje për të balë,¹⁾
për pushtonjës e vasalë,
po ndjek udhën e vërtet';

thonë vjen, e mirë thonë,
vjen me të liria jonë. —
Liri popullit për jetë.


1942

(Botohet për herë të parë)

1) të balë = të damkosur


EPOPEJA E BALLIT KOMBËTAR

Poemë satirike në tri pjesë



PJESA I

Pas dorëheqjes së Musolinit, kur Italia fashiste hate te s'mbante më, krerët e Ballit Kombëtar si Mithat Frashëri e Ali Këlcyra me shokë, që ishin futur gjër në grykë në tradhëti për bashkëpunim me okupatorin, u munduan të dilnin nga kjo pozitë duke kërkuar bashkëpunim me partizanët. Bashkëpunimin e kërkonin sa për sy e faqe, me qëllim që, pas disa ditësh, kur të kapitullonte Italia, të ktheheshin me pretendime: Ishte fjala tek pushteti që kërkonin të merrnin dhe një herë në dorë nga merakun se mos ky pushtet — për rrezik të «Kombit» — binte në duar të popullit. Dhe atëhere, vajmëdet! Po populli, që e kish të qartë pse luftonte, sepse kish bërë të tijën me kohë vijën e shëndoshë politike të Partisë Komuniste Shqiptare, i bëri paçet Ballit dhe Balli mbeti me gisht në gojë.



I

U mbyt gjemia
me federalë!
O burra, shpejto,
kush mund të dalë!

Paçet fashizmit
e vinceremo-s,¹⁾
se iku koha
e Baba Qemos,

se me avazin
glories romane
vate dhe çorba
musoliniane.

Pa me gusht bashkë
ikën dhe vapa,
zoti na ruajt
ç'dimër vjen prapa!

1) vinceremo — do të fitojmë (parulla e famshme e Musolinit).

S'ka në Parian
në Real Palazzo
as Kol Biban,
signor Dalmazzo...

Ç'e ndreq me popullin
që s'di ç'kërkon?
Do kthyer fleta,
sa s'është von'.

Pa dy-tri pushkë
dhe ne armiqe,
addio bello,¹⁾
fron' e çifliqe.

Do na mbulojnë
plehrat e tokës,
do ngrihen këmbët
t'i bien kokës;

do dalë djalli
nga fund' i dheut,

1) bello — e mira, e mbara, ajo që presim.

do ngrihet bujku
t'i thotë beut:

«Ç'bëje zotrote,
bej efendi,
kur unë luftoja
për Shqipëri?»

Pa do të nxjerrë
kushdi ç'defterë,
Zjarr' i xhehnemit
mbi ne do bjerë.

Shpejt, pra, me popull
dhe ne në çetë:
atdhen' e lirë
ta bëjmë vetë.

T'i kthejmë pushkën
mikut që pamë;¹⁾
t'i marrim xhanë,
se ndryshe... vamë!

1) pamë — patëm

...Na ngordhi kali,
i ranë thonjtë;
ç'po vrapon Balli
t'i heqë patkonjtë.

Flet Ali Beu:
— «Luftë për atdhe,
se sot atdheu
pret shumë nga ne.

Na zjen në deje
gjak shqipëtari;
s'durojmë kurrë
zgjedhë barbari.

Fashizmi i krisur
me ca tradhtarë
na shkeli vatrat,
na bëri varrë.

Ngrihi t'i biem
jezitet plak,
se Shqipëria
s'lind dot pa gjak...»

Pa kur t'i shohësh
derven'-dervenë,
në vend të pushkës
gota dhe enë;

jaka të ngrira,
bastun', ombrella
pantofla, gante,
pixham', kapella.

— Do bëjmë luftë,
de more de,
si lum ti popull,
mezi na ke! —

Pa nis dollia,
theren kurbanët,
vardha¹⁾ rakia,
poshtë italianët!

— Pije me fund
të kam rixha:
shëndetja e flamurit
s'i thonë shaka.

1) vardha — pareshtur

Do bëjmë luftë,
do tundim malet... —
dhe fshati qeshet
dhe bota tallet.

Dhe vendi pyet:
ç'vapor i solli?
Ku ish gjer dje
kjo farë sokoli?

Ç'thua ti Daj Ceni?
— S'di gja, o vlla!
M'bahet janë bullica¹⁾
n'tevdil hava.

— Do bëjmë luftë
me armiqt' barbarë;
s'kini ku futi,
dridhi tradhtarë! —

Kush janë tradhtarët?
— Shohim e bëjmë;

1) Bullica u thoshte Dajë Ceni ballistëve në dialektin e tij.

të marrim frenat
pastaj e gjejmë...

— E banë luftën
me pulastrena,
tash duen dhe frenat —
gjëmon Daj Cena.

— Dyrnjan' sulltanë
ndrruen k'ta horra
e'i herë dajakun
s'e shluen nga dora.

Tash? Ke ne vrapin,
si qent' për petlla,
t'na hjekin sytë,
me na vu vetlla...

Po kush s'i njeft se?
Nji ku ua thot' Daja:
«me k'si horlliqesh
asht fa dyrnjaja.»

*

* *

Pëllëmbë e gjak
andej matanë
luftojnë e s'tunden
bijt' partizanë.

Prej vjet'sh me popull,
në luft', në zjarr,
me grusht imperon¹⁾
e shtin' në varr.

As bukë as ujë,
as rreckë veshur,
këpucët shqyer
po armët ngjeshur;

nga lufta kthehen
shkëmbenjsh debojë²⁾
me gaz në buzë,
me këngë në gojë...

1) impero — perandori (italisht)

2) debojë — depo armësh.

— Pa dale, shokë,
dëgjohet zhurmë!
Ku vete vallë
ky varg, kjo turmë?

Kush po na vjen,
si varg rebelash,
me kaq urgjen'
shirk¹⁾ pas të vjelash?

Na qenka Balli!
Dale, pa dale...
E ç'kërkon Balli
kaq von' në male? —

Del Lumo Skëndua
(Alias Mithati)
me jak' të gjerë
prej diplomati.

— Sot, djem, është dita
për luftë vigane;

1) shirk — kaciq, shakull (lëkurë e tharë, që përdoret si enë për gjëra ushqimore).

s'duron shqiptari
zgjedhë italiane

Mjajt hoq'm e vuam, —
milic', kuesturë,
kuislingë, gregarë¹⁾
s'lanë bashk' dy gurë.

Gjer Librarinë
në Rrugë Mbretnore²⁾
dy herë ma mbyllnë:
ç'vepër mizore!

— Viktimë — thotë Dosti —
vajta dhe unë,
me zor ministër
vanë e më vunë.

S'do ta pranoja
jo, për Flamur,

1) gregar — hierark (nga italishtja)

2) Rruga Mbretnore — sot Rruga e Barrikadave në
Tiranë.

po Mithat Beu
më bë' mexhbur.¹⁾

Del Faik Quku:
— Në aksion të Milotit,
shtatqind vetë kapa
për bes' të Zotit!

Por vetëm shtatë
më njoh'n për zot;
tjerët kishin pushkë,
s'i mbajta dot.

Dale — thotë tjetri —
jemi dhe na,
s'e kemi ngrënë
badijava... —

Ca avokatë,
ca profesorë,
gjithë po na dalin
heronj... therorë!

1) më bë' mexhbur — më detyroi.

Të gjith' të pushkës,
të gjith' të malit
tashti që i ranë
patkonjtë kalit.

— Jemi për luftë!
S'ka prit të presim,
të huajt me shkelme
jasht' do t'i qesim.

Ne si ballistë,
ju partizanë:
bashkim sot duhet
të fitojmë davanë.

Shqipërinë ta lindim,
tradhtar't t'i grijmë
e popullit tonë
burrnisht t'i prijëmë. —

Qeshet Daj Ceni:
— Të quet për besë:
s'kan' mjellë një kokërr
e thon' duem pjesë!

Sa shpejt, bre burra,
kthyet nga qabeja?!
Na dogjme duert,
ju vrap n'gështeja...

PJESA II

Ballistët kthehen nga mali të dëshpëruar. Kanë lënë mjekër e mustaqe dhe dalin fare rrallë në pazar, që të japin përshtypjen se bëjnë jetë ilegale. Kjo është edhe parulla zyrtare e Ballit Kombëtar. Po komedia nuk zgjat shumë, se gjermanët, që erdhën menjëherë në vend të Italisë së kapitulluar, u interesuan shpejt të ngrenë pushtetin e shpartalluar kuisling dhe dallaveret e ballistëve për të marrë secili nga një pozitë të mirë në pushtet, filluan. Nuk u desh shumë kohë që Balli të hidhej kokë e këmbë në prehër të komandaturës gjermane. Vëllazërohet me Legalitetin e Abaz Kupit, që sapo është përzënë nga Fronti Nacionalçlirimtar; bëhet lajmës për një krushqi të ngushtë në mes të Mustafa Krujës e të zogistëve dhe duke u ofruar gjermanëve bashkëpunimin e tij më të ngushtë, bërtet më shumë nga të gjithë kundër «rezikut të huaj». Gjermanët e organizuan reaksionin e brendshëm, e bashkuan dhe e hodhën në luftë totale kundër Luftës Nacionalçlirimtare të popullit. Paralel me ofensivat e mëdha të dimrit dhe me terrorin e

madh nëpër qytete, ish lëshuar në sulm kundër rezistencës sonë antifashiste edhe propaganda kuislinge. Paraqiten në këtë pjesë figura të vogla, të shkëputura, që kanë të bëjnë secila me një nga ato manevra dhe akte demagogjike të poshtër të Ballit e të Legalitetit, që na panë sytë atë dimër të tmerrshëm të 1944-ës. Pjesa përfundon me rezistencën heroike që i bëri populli ynë rrebeshit gjermano-kuisling.

II

Thonë s'fle deti,
thonë s'fle lumi,
po Mithat Benë
s'e zë hiç gjumi.

— Me partizanët
një djall na polli,
plani që bëmë
në kut s'na dolli.

E humbëm (kartën,
për ne gjë s'mbeti,
në duar të popullit
po bie pushteti!

Dhe mirë na gjeti,
se aq mend patëm;

punët si duhet
dje nuk i matëm.

Kot nximë faqen,
u turpëruam,
nga miqt' fashistë
gjë s'përfituam.

Desh bërë Shqipëria
det e tërmet,
që t'vin' në vete
ky djall milet.

Po ne kërkuam
si n'vaft kadilerësh
me një gur t'vrisnim
dy zogj njëherësh.

Tashti ramë brenda,
s'ka ç'na shpëton;
mirë i thonë fjalës:
kush bën, pëson.

Po gjene Balli
s'e bjerr kurajën,
se Perëndia
do bëjë të sajën.

Dhe ja, nga Zoti;
një sofër tjetër
na del përpara
si sof'r e vjetër:

gjermanët erdhën
dhe partizanët
u hapën luftë
në të gjith' anët.

Tani s'ka fjalë,
zotrinj të ndritur,
një plan më i gjerë
duhet goditur.

Duhet studiuar
të gjitha shtigjet, —
mishi të piqet,
helli mos digjet.

Se po e Humbëm,
parole d'honneur,¹⁾
jemi të gjithë
për në satër...

*
* *
*

Ç'po afron vjeshta,
s'fryn me zefir:
kthehen lejlekët
prap' në Misir.

Kthehen ballistët
prap' në qytet;
jeta në male
s'ka më lezet...

Vijn', e si vijnë?
Taborr'-taborrë,
zbresin nga malet
triumfatorë.

1) parole d'honneur — për fjalë të nderit (frëngjisht)

Ca me mustaqe,
ça me kasketa:
vijnë nga çeta.
mor tungjatjeta.

— Vijnë nga çeta
se, lum zotnia,
t'luftojmë gjermanët
s'na lë Partia... —

Qahen madamat:
— Ky mal i shkretë
ibret na i bëri
burrat e djemtë;

po shiko motër .
mos hapësh fjalë,
se, dhe që kthyen,
janë ilegalë... —

Kështu qe fjala,
ky qe kuvendi,
po Ball mavrinë
s'e mban dot vendi.

Në Albergo Dajti¹⁾
vëlon dollia,
Gestapua çirret
se Shqipëria

s'është zaptuar.
— Ahere ç'bëjmë?
O burra brenda!
Fjalën ta gjejmë.

Po edhe brenda
kini kujdes;
s'bën të hyjë Balli
gjith' në një thes.

Se kundërshtarët
në gaz e kanë
të na ndyjnë emrin
anë edhe mbanë.

Kurse ne hallin
e kemi ndryshe:

1) albergo — hotel (italisht)

si të fryjë era
k'the dallandyshe. —

.....

Dhe lodra nisi:
Balli mënjanë,
Deva në tjetrën,
e zgjidhën davanë.

Me komitete
me Asamblera,
me feldgendarmë
roje te dera.

Thonë e ç'nuk thonë,
kush u vë re?
— Shqipërinë e lirë
e bëmë ne;

po hesap s'duam
për ç'është bërë:
Shqipni e Shqiptarve,
bujrëm të tërë! —

U shkulën fashistët
ngado që qenë, —
kur u pjell viçi,
pse të mos venë?

Hurshit, Kolgjin,
e Zim Mullet;
Kllëç¹⁾ i Mustafës
prap' vret e pret

Pastaj Regjencë!
Ja edhe Bazit
sa mirë pështyma
i rr'shqet gurmazit.

Ball, Kup e Krujë
një me gjermanë,
se «miqt' e miqve
janë miqtë tanë.»

— Ç'na duhet tjetër
ortak në short.

1) kllëç — shpatë, jatagan, pallë.

kur ne, shumica,
jemi dakord?

Shpejto të shpallim
Legalitetin.
se edhe populli
s'kërkon veç mbretin.

E gjithë bashkë
zërin ta çojmë,
bashkim'n e popullit
të predikojmë:

— Bashkim, vëllezër,
këtu tek jemi,
se sa për gjetkë...
s'kemi ku vemi.

E gjetën fjalën
shoku me shok,
bashkim bërtasin
të gjithë tok.

E britmat venë
në majë të malit,
po mbi të gjitha
del britm' e Ballit:

— Bashkim, bre burra
gjithshka për Atdhe!
Terror, vllavrasje
s'janë mall për ne.

— Bashkim? Si vallë?
Ndyrë e përlyer?
Tek valon flamuri
me kryq të thyer?

S'përgjigjet Balli
nuk i sifer...¹⁾
po gjuh' e gjarp'rit
derdh helm' e vrer:

— Na mbynë të huajt:
grekë, sërbyanë,
bullgar', kinezë,
rús', italianë.

1) sifer — intereson

Se djemtë e çmendur
të vendit tënë
sofër të botës
Shqipërin' e bënë.

U ngopën pare
bijtë e pabesë
e sot Atdheut
s'ia kanë për pesë.

Po ne do i zhdukim
këta tradhtarë,
se na ndynë emrin
si shqipëtarë.

.....

Kor i kurdisur
njësoj kudo
që nga Regjenca
në Gestapo.

Dhe që nga Balli
e gjer te Bazi

njësoj është kënga,
njësoj avazi.

*
* *
*

Bashkim i Kombit!
Flet herr Telhai:
— Kupa po mbushet,
i kujt është faji?

I djemve tanë.
Haram ta kenë:
Luftojnë gjermanin,
mohojnë Atdhenë.

Ne, si Evropë,
borxh kemi sot
qytetërimin
t'i dalim zot,

se bolshevizmi
ja ku po vjen

dhe ç'gjen përpara
shemb e rrëmben.

Shkruam e folmë
na zu' veremi
po s'na kuptojnë
sa hakë kemi.

Tashti: «*t'u biem!*»
Kjo është fjala;
ç'nuk bëri shkrimi
ta bëjë palla. —

Bravo Telhaku!
E ke hallall, —
një Doktor Goebbels
brenda në Ball.

.....

Legaliteti
po korr e grin:
dy lekë «*Atdheu*»,
shtyp klandestin!

Sikur s'e dinë
hallku, gjermani,
ç'bën Gaqo Gogua
te Mal Osmani

.....

Brashnjat¹⁾ e leckat,
që la Partia
si Staravecka
e Xhep hafia,

shpallën me bujë:
Ballo-zogiste,
një parti tjetër
më komuniste!

Parti me halle,
jo për në male,
po për në valle
demosociale.

1) brashnjat — këpucë të vjetra që s'hyjnë në punë, që hidhen poshtë.

.....

Çunat e Ballit,
shkrimtarë, poetë,
me lot na e qajnë
Shqipërinë e shkretë:

— Mallkuar qoftë
fashizmi i zi,
që i thoshte vetes
perandori.

S'pat turp qafiri,
ah, shtatë prilli!
Uh, robëria!
Bubu, katili!

Mbi fisin tonë
ra si rrebesh
dhe vëllavrasjen
na la peshqesh

Në gjak u mbytmë
në lot u shkrimë,

në luftë si burrat
u vramë, u grimë...

Po ja prap' fati
dhe kësaj radhe
s'na la ta g'zojmë
Shqipërinë e Madhe.

Shqipërinë e lirë,
q'e bëmë vet',
që na kushtoi
gjak sa një det...

— Dale bre çuna,
se s'ishit ju
ata që e shpunë
gjakun në gju.

Pastaj ç'na flisni
për italianë,
kur kini brenda
derro gjermanë?

Apo na flisni,
se s'kishit nge
nga çirkostancat
të flisnit dje?

.....

Gjëmon «Savoia»,¹⁾
po flet e falet
një trim i Ballit,²⁾
që vjen nga malet...

Në prag të derës
gjerman' për roje,
flet bir' i botës
pa pikë droje:

— Ne jemi forca
thjesht' kombëtare,
të huaj nuk duam
në tok' shqiptare.

1) Kinema «Savoja» — sot Teatri popullor
2) Abaz Ermeni

Në luftë sot duhet
tradhtar't partizanë
në gjak t'i mbytim
ku janë, ku s'janë.

Applausi,¹⁾ forca!
troket legeni;
qesh feldgendarmi:
«Gut herr Ermeni!»

*

* * *

Tym edhe flakë
më katër anë
ballistë, xhandarë.
kuislingë, gjermanë.

Gjer Mitrovica²⁾
ka marrë pjesë

1) applausi — duartrokitje (italisht)

2) nga Mitrovica ish-in Xhafer Deva, Xhelal Mitrovica e të tjerë kuislingë të orës së parë.

në sulm të poshtër
me të pabesë.

Me thikë mbi popull,
mbi foshnja e gra,
çnderim, masakër,
terror, hata!

Kudo kufoma
e shkrumb e hi:
është luft' e Ballit
për Shqipëri...

Ja dhe qytetet
u mbushën gjak,
pa klithmë e drithmë
nuk mbeti prag.

E Balli akoma,
hienë¹⁾ gjaksore,
mbi eshtra të popullit
kërkon fitore.

1) hienë — shtazë e egër që ushqehet me kufoma.

Po trimat s'tunden —
det e tërmet,
mbi kokë të armiqve,
grushti kërcet.

Gjëmojnë malet,
lufta vlon, —
zaptues, tradhtarë
godit, dërmon.

E bota e tërë
na thur lavdi
për moton tonë:
Vdekje a Liri!

PJESA III

Të çelurit e gjethes e gjeti lëvizjen tonë shumë më të fortë dhe më të organizuar nga ç'ishte gjatë dimrit. Kjo i la gojëhapët tradhtarët, të cilët qenë të bindur në fillim se, me friticët për aleatë dhe me terrorin në masë, do të shuhej gjer në pranverë fara e partizanëve. Pas kësaj do ta kthenin festën mbi sy, sepse çdo të huaji, që do të okuponte Shqipërinë pas katastrofës gjermane, e cila shihej fare afër, do t'i dilnin ata përpara si veqilë të popullit dhe përfaqësues të rezistencës. Gjermanët prerogativën në këtë kohë ofensivën e dytë me qëllim që t'u hapnin udhë nëpër Shqipëri divizioneve, që do të tërhiqeshin nga Greqia dhe kërkonin mobilizimin total të reaksionit. Po çështja paraqitej shumë e vështirë se ballistëve u kishte hyrë data. Shumë vetë që s'ishin futur thellë në tradhëti filluan t'u dorëzohen forcave partizane, kurse të tjerët, që kishin mëkate për të larë, kërkonin ndërmjetësi për falje dhe ishin gati të dorëzoheshin. Krerët si

Mithat Beu me shokë që s'i lante dot as dërstila, ngulnin këmbë për rezistencë, gjersa të zbarkonin... englezët. Kjo pëshpëritej vesh më vesh, natyrisht, si një «lajm nga brenda», po as kësaj s'i besonte më njeri. Paniku kish hyrë gjer brenda në familjet e oxhakëve reaksionarë, që ishin mbështetja kryesore e okupatorit. Vetëm një fjalë do të mund t'i ngushëllonte tani bandat e demoralizuara të reaksionit — fjala që hapën vetë krrerët e Ballit Kombëtar e të Legalitetit se gjoja të dyja organizatat e tradhëtisë po vinin në ujdi me partizanët që të dilnin përsëri në mal. Po këtu u del përpara një fshatar i thjeshtë, Dajë Ceni, dhe u dëfton vendin, atë vend që u dëftoi populli me drejtësinë e tij.

III

Vate dhe dimri,
se kaq e pat.
Zogj e bullica¹⁾
s'gjejnë më rehat.

Se gjethja çeli
dhe malet plot
u mbushn' akoma
armë e barot.

— Një kupë verë,
garson, në daç!
Sot me të lutur,
dje me kërbaç...

1) Zogistë e ballistë

Thuaj ç'të duash,
të njoh, më njeh,
m'i di të gjitha,
s'kam ç'të të fsheh.

I tillë isha.
Po jam penduar,
sot me të gjitha
jam dorëzuar.

Kështu e paska
kjo botë jallane:
ngryse piperkë,
gdhin patëlxhane.

Kush e kish njohur
lanetin Ball?
Vate na futi
në këtë hall!

Krerët për vete
bëjnë si bëjnë,
po ne bishtprerët
ç'udhë të gjejmë?

Udhën e malit?..
E di, o v'lla,
po jam dënuar
dhe nuk ma mba.

Në ke mëshirë
gjëmë shpëtim:
nem një letër
rekomandim.

Ke kushëririn
në bataljon
dhe fjal' e tija
ku nuk shkon?

U ranë pendët,
se dhe gjermani
po përdredh bishtin
si italiani.

.....

Shtëpitë e krimit
nxijnë e sterrojnë,

ëndrrat, fallxheshat
shumë keq tregojnë:

— Të të rrëfenj,
të të dëftenj
keq, zonjë, e paske
me fukarenj...

Liksht dëftuakan
bathët, për besë,
hatëri, qejfi,
zonjë, mos jesë:

sikur nga malet
një lumë zbret
dhe merr me vete
bej e dovlet...

Zonjush' Lejlasë
s'i ndrit më nuri,
ka varur buzët
si streh' hauri.

Dhe Hanko zonjës,
aq sa kish hije,
i nxim sot balli
si fund kusie.

Pa flet e çirret,
thërret, bërtet;
është mbushur tërë
nervozitet:

— S'bë' gjë es-esi,
as Fritz Kaputi,
s'mbaroka kurrë
kjo farë harbuti,

si far' e hithësit,
që mbush dynjanë, —
e pret këtu,
të mbin matanë.

Ç'bëni ju burrat?
Ju humbtë vula!
Haram i paçi
byrek e pula.

Se turpëruat
komb e Atdhe...
Doni t'ju vimë
prapa dhe ne?

Këtë e bëri
harbutëria.
Si mund ta bëjë
'ristokracia?!

— Lerna, moj grua,
se s'jam hiç mirë;
kam plot r. jë javë
me gjak të ngrirë.

Ç'hyjnë më llafet
në këtë mes?
Ne kemi vajtur
në teknefes.

Lena, të thashë,
për kokë tënde;
ata po vijjnë...
ti na shet mënde.



Thonë, gjermanët
prap' po sulmojnë,
Shqiprinë e Jugut
do ta rrethojnë.

Dhe prag e vatër
s'do lënë më këmbë,
njerëz të gjallë
do hanë me dhëmbë.

Me ta dhe Balli,
si bisht sqepari,
pushtet kuislingun
do ngrerë i pari.

Mithat Bej Frashër
e Hysni Demë
kanë lidhur fjalën,
kanë bërë benë

se këtë radhë
ia bëjnë fora;

s'lënë më t'u ikë
zogu nga dora.

Pa del kushtrimi
telegrafik:
— Ngrehu në luftë,
popull kreshnik!

O burra ç'jeni,
xhandarë, ballistë
yrysh të tërë
mbi komunistë!

Yrysh, pa gajle,
mbi partizanë,
se erdh sahati
t'i dalim mbanë. —

— Yrysh, po puna
qenka me rrota,
se partizanët
i njeh gjith' bota.

Hordhitë e Ballit
bashk' me gjendarmët

andej nga Jugu
po hedhin armët.

Dhe krerët ranë
nga tartaposhi,¹⁾
se katandisi
një thelë kokoshi.

Pa dhe inglizi
me shumë ilete,
që thonë se Balli
e ka me vete,

me sot e nesër
na mbushi vrer',
s'e bëri kurrë
qejfin qeder.

Si duket, miku
dhe kësaj here
kërkon t'i zërë
lepujt me qerre.

1) tartaposh — 'vend' i lartë, një lloj divani i dalë në formë ballkoni që kishin zakonisht shtëpitë e vjetra feudale.

Po vate, vate,
i dashur mik,
diplomacia
a la Munik!

Sot edhe foshnja
të sjell vërdallë,
t'i njeh nga rrënjët
dhëmbë e dhëmballë...

— Dale vëllako,
mos humb toruan,
ka punë puna
dhe pse s'fituam.

S'paske sy fare
për diplomat!
Nuk di që puna
nd'rron me sahat?

— Leri të lutem
këto shakara,
po hiq pallackat
e bëj përpara.

Se me shiringa
na ngopi Balli;
tani arriti
tek s'mban më halli.



Flitet një fjalë
dalë e ngadalë
sikur prap' Balli
në mal do dalë,

sikur po ardhkan
dakord dy anët
për v'llazrim armësh
me partizanët.

Pa qënka udha
që do ta nxjerrë
si molla Ballin
dhe këtë herë...

Hidhet Daj Ceni:
— A thue për ime

andrronj' prap horrat
vllaznim me ne?

Çere duen s'di Daja
sagllam me u thanë,
veç dru, se mangut
do d'rrasa i kanë.

Hala ke ura
ky xhins tradhtar!
kujton qi poplli
s'han bukë po bar.

Me t'huejt për krahi
n'gjak vllau zhyt',
ia ngulën pop'llit
thikën në fyt.

Na vran' Shqypninë,
na vran' djelmninë;
mish robi u nginë,
sa pat'n fuqinë.

Tash me kthye fletën
fijet po i ngrehin:
për v'lla me popull
kan' ftyr' e lehin.

Asht e nelueme
asht e nelueme!
Ua pamë hajrin
ver'n e kalueme.

Tash jo, vallahi,
S'ua duem surratin:
bullicat m'baltë
e kanë rahatin.

Der t'i mrrin ora
dajës (për besë!)
kur t'i mshij' pop'lli
plehnat me mshesë.

1944

SHPJEGIME EMRASH

Abaz Kupi — Bajraktar nga Kruja, ish major i regjimit zogist. Me mënyra të kamufluara u orvat të sabotojë Luftën Nacionalçlirimtare kundër fashizmit italian. Gjatë okupacionit gjerman vuri të gjitha forcat e tij në dispozicion të armikut për luftë kundër popullit.

Ali Beu — Ali Këlcyra, bej nga Këlcyra e Përmetit, një nga organizatorët e vijës së parë të Ballit Kombëtar si dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Luogotenencës e i Komandës së Lartë të forcave italiane në Shqipëri.

Atdheu — Gazetë e «Legalitetit». Botohej në Tiranë me dijen e gjermanëve, po gazeta mbante të shkruar se «botohet në malet kreshnike».

Bashkimi i Kombit — gazetë e përditëshme e frontit
kuisling në kohën e okupacionit gjerman.

Dajë Ceni — fshatar nga Priska e Tiranës.

Dalmazzo — gjeneral Dalmazzo, komandant i përgjithëshëm i ushtrisë italiane në Shqipëri
në kohën e kapitullimit të Italisë.

Dosti — Hasan Dosti, një nga eksponentët e Ballit
Kombëtar, ish ministër i Drejtësisë nën
okupacionin italian.

Ermeni — Abaz Ermeni, eksponent ballist, koman-
dant i një bande të madhe ballistësh në
rrethet e Beratit.

Goebbels — ministër i propagandës naziste.

Gaqo Gogua — zogist, redaktor dhe përgjegjës tek-
nik i gazetës «Atdheu».

Hurshit — Javer Hurshiti, komisar i lartë fashist
për prefekturën e Gjirokastrës e të Vlorës.

Hysni Dema — Oficer i kohës së Zogut, anëtar aktiv i «Legalitetit» në kohën e gjermanëve dhe njëkohësisht komandant i përgjithshëm i gjindarmërisë kuislinge.

Kol Biban — Kol Bibë Mirakaj, ish ministër i Punëve të Brendshme në kohën e dorëheqjes së Musolinit.

Kolgin — Tahir Kolgjini, ish prefekt i Gjirokastrës në kohën e okupacionit italian.

Legalitet — organizatë zogiste.

Lumo Skëndo — pseudonim i vjetër i Mithat Frashërit.

Mal Osmani — Ismail Osmani, ish pronar i shtypshkronjës «Gutenberg», ku botohej gazeta «Atdheu».

Mithat Frashëri — Kryetar i organizatës tradhëtare Balli Kombëtar.

Mustafa Kruja — fashist i orës së parë.

Parian — gjeneral Alberto Pariani, një nga agjentët e parë të fashizmit italian në Shqipëri, organizator i ushtrisë në kohën e Zogut.

social-demokratja — U krijua për demagogji nga njerëz të Ballit Kombëtar, që gjoja nuk ishin dakord me rrugën që ndiqte Balli i Mithat Beut.

Staravecka — Xhelal Staravecka, dezertor e tradhtar.

Telhai — Eqrem Telhai ballist i flakët, një nga kalemxhinjtë e njohur të gazetës kuislinge «Bashkimi i Kombit».

Xhafer Deva — ministër i brendshëm kuisling në kohën e okupacionit gjerman.

Xhep — Pseudonim i Sadik Premtes, që ish përjashtuar nga Partia Komuniste si fraksionist (përçarës), u bashkua me Ballin Kom-

bëtar dhe pastaj u bë vegël direkte e gjermanëve.

Zim — Zim ose Qazim Mulleti, prefekti i Tiranës në kohën e Italisë fashiste; merrte vetë pjesë në vrasjen e patriotëve. Gjermanët e bënë përsëri prefekt të kryeqytetit.

MARSH I DIVIZIONIT TË PARË

I

Gjëmojnë malet shqipëtare
dhe toka zien anëmbanë,
se ra ushtria çlirimtare
në sulm mbi hunë dhe tiranë.

Me gjak e flakë pagëzuar,
me bijt' më trimë luftëtarë,
dërmon armiqt' e mallkuar
në sulme Divizion' i Parë.

Në sulm, në sulm, në flakë, në zjarr
ngre flamurin e lirisë kudo;
jep dritë trollit shqipëtar,
hap rrugë popullit hero.

II

Mbi hekur, zjarr e mbi fortesë
me armë turret e barut;
shkatrron e thyen çdo pengesë,
armiqve drithm' e tmerr u fut.

Mbi dhen' e mburjtur gjak martirësh
s'ka forc' e prit' që të pengon:
çliro Atdhenë prej zinxhirësh
me sulm e luftë Divizion.

III

Se mjaft me helm e me zaptie¹⁾
armiku egër mbretëroi;
sot or' e popullit po bie,
sot ylli për çlirim agoi.

Me gjak arb'rori çelnikosur,
mbi troje gjyshësh legjendarë, —

1) zaptie: xhandarë

shkatrro armikun e plagosur,
në sulme Divizion' i Parë.

Gusht — 1944

HIMNI I KORPARMATËS SË PARË

Me armë e me flamurë
zjen tok' e Shqipërisë,
shtje grusht'n e fundit populli
mbi prangat e rob'risë.

Dhe varret me dëshmorë
po zgjohen nga gëzimi,
se ranë gjer në qytete
me mijra yj' çlirimi.

Ja sot, me divizione,
mbi zjarr e mbi granata,
vigane sipër ngrihet
me flamuj Korparmata.

Dhe zbret si lum' me valë,
si deti në duhi;

shkrin hekur mbi armiqtë,
sjell popullit liri.

Përpara, Korparmatë,
armik mos ler' mbi dhe;
me gjakun e herojve,
ndërto Shqipërin' e Re!
U shtri në gjunj' tirani
në frik' e në rrëmete:
ja hapu dhé të futet,
ja s'ka më vend ku vete,

se hak' e gjith një populli
të shtypur e të vrarë
ndez zemrat e dragonjve
të Korparmatës së Parë.

Ndez zemrat edhe lufta
më e tmerrshme sot shpërthen,
në qiellin tym e flakë
një yll i madh shkëlqen.

Një yll i ri për popull,
që kurrë s'do perëndojë,

se zjarr' i Korparmatës
përpara bën mburojë.

Shtator — 1944

USHTO, MOJ KËNGË!

Marshon me hap të ri Shqipëria trime,
me kazm' e pushkë në revolucion;
komplot e plan armik i bën thërrime,
si himn fitoresh kënga larg ushton.

Ushto, moj këngë, në fitore,
më lart, më larg ushto;
nga malet në fushat pjellore
hare shpërnda kudo.

Ushtri besnike i jemi ne Partisë,
me këng' e gaz sulmojmë ku na thërret;
me gjoks, si shqipja, i bëjmë ball' stuhisë
në tokën zjarr, në qiell dhe në det.

Nuk pyesim ne pengesë dhe rrezik
as dhelpëri, kanosje dhe blokadë, —

drejt diellit çajmë dhe për çdo armik
barutin kurdoher' e mbajm' të thatë.

Fuqi-vullkan na jep ideja jonë,
marksizëm-leninizmi ngadhënjimtar;
rendit të vjetër rrënjët i shkat'rojmë
me zjarr revolucioni proletar.

Ushto, moj këngë, në fitore,
më lart, më larg ushto;
nga malet në fushat pjellore
hare shpërnda kudo.

(Botuar në gazetën «Drita», 1966)

SULMOJNË ÇIKAT VULLNETARE

Sulmojnë çikat vullnetare
drejt maleve, bokrrimave;
shkëmbenjtë kthejnë në ugare
me vrull'n e vetëtimave.

I pastër ky veriu i malit,
si zemra e vullnetarëve,
si frym' e vetë partizanit,
q'u vra vitet e zjarreve.

Malesh, mbi gjurma heroizmi,
djersin e lodhet çika,
që të lulzojë socializmi,
të ndrijë Republika.

I fortë shkëmbi lart në mal,
ushton gjëmimi grykave, —
po s'paska forcë që e ndal
vrullin e madh të çikave.

Ngjiten taracat vija-vija
drejt maleve të larta,
krenohet mbarë Shqipëria
për çikat zemërzjarra.

(Botuar në gazetën «Drita», 1966)

KËNGA E METALURGUT

Frenat që nga kabina
sa prek kjo dora ime
zien e shfren uzina
me drithma dhe gjëmime.

Rrëshqet gjigant çikriku,
shpejt vinxhi vet' e vjen
dhe blloqet prej çeliku
si fije kashte i ngren.

Çelik të thonë, babush,
po kur jap urdhër vetë,
të skuqet faqja prush,
palosesh, bëhesh petë.

Të nd'rroj unë si dua:
në shufër, tel, thërmi, —

pra s'matesh dot me mua,
çelik jam unë, jo ti.

Botuar në gazetën «Drita», 1966

PASQYRA E LËNDËS

| | Faqe |
|--|------|
| Perëndim | 3 |
| Mëngjezi | 5 |
| Në fshat | 7 |
| <i>Bujku i Hanko Hallës (poemë)</i> | 9 |
| Vështrimit tënd | 16 |
| Mendim dhe lotë | 18 |
| Katundarëve | 19 |
| Vitin e gjashtë | 22 |
| Vetëm me ty | 25 |
| <i>Nga cikli «Këngët e sirtareve» (1936)</i> | 27 |
| Fol', poet! | 29 |
| Ç'thotë Vala? | 32 |
| Patriotit të përbuzur | 34 |
| Një shoku | 37 |
| Eja | 39 |
| Kasolles | 41 |
| Mëngjez e mbrëmje pas dritares | 42 |
| Kur thyhet lundra | 44 |
| Ëndërr | 46 |
| Kërkova jetë | 47 |
| Liri popullit për jetë | 48 |

| | Faqe |
|--|------|
| <i>Epopeja e Ballit Kombëtar (poemë)</i> | 51 |
| Marsh i Divizionit të parë | 110 |
| Himni i Korparmatë së parë | 113 |
| Ushto, moj këngë! | 116 |
| Sulmojnë çikat vullnetare | 118 |
| Kënga e metalurgut | 120 |